



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PER SHERBIM TE QYTETAREVE
CENTAR ZA USLUGU GRADANA

Sh. 02 Nr. 1858
U. Br.

Num. Maq. 2 Data: 19/01/2023

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



LAUREATËT E VITIT 2022

Duke u mbështetur në traditën e përvjetshme, si dhe për të stimuluar aktivitetet dhe punën në lëminë e sportit, Komuna e Kamenicës, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, edhe këtë vit do të organizojë shpalljen e sportistëve më të dalluar për vitin 2022.

Shpalljen e më të dalluarve nga lëmia e sportit do ta bëjë Komisioni i formuar enkas për këtë qëllim, nga zyrtarë, pedagogë dhe gazetarë të sportit nga Komuna e Kamenicës.

Me këtë rast do të zgjedhen:

- Sportisti/ja i/e vitit 2022
- Klubi më i dalluar
- Trajneri më i dalluar
- Gjyqtari më i dalluar i sportit
- Shpresat e sportit të Komunës së Kamenicës
- Çmimin special për kontributin e dhënë në sport
- Sportisti i zgjedhur nga publiku (i cili do të zgjidhet gjatë ceremonisë)

Drejtorja e Kulturës, e Rinisë dhe e Sportit, fton të gjitha Klubet dhe Shoqatat sportive që veprojnë në kuadër të Komunës së Kamenicës, që propozimet e tyre bashkë me arsyetim t'i paraqesin nga data 18.01.2023, ora 8:00 deri ora 16:00, deri më 25.01.2023, në orën 12.00. Në propozimin për laureatët duhet në mënyrë të qartë të përshkruhet aktiviteti i secilit sportist dhe të specifikohen të gjitha garat ekipore dhe individuale në të cilat ka garuar sportisti dhe suksesin të cilin e ka arritur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar gjatë vitit 2022.

Ceremonia e përzgjedhjes do të bëhet me datë 30.01.2023 në Shtëpinë e Kulturës "Isa Kastrati" në Kamenicë në ora 14:00.

Propozimet duhet t'i dërgohen Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në Zyrën për Shërbime me Qytetarët, në zarf të mbyllur me mbishkrimin: "**Propozim për shpalljen e sportistëve më të mirë të vitit**"

Të gjitha çështjet që lidhen me shpalljen e laureatëve, mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike duke dërguar e-mail në adresën: Përgjegjësit për Sport, Agim Avdullahu, agim.avdullahi@rks-gov.net.



Propozim për Komision nga zyrtarë, pedagogë dhe gazetarë të sportit nga Kamenica.

Komision		Instucioni	Nënshkrimi
Agim Avdullahu	Kryesues	DKRS	
Ajshe Thaqi	Anëtar	DKRS	
Agim Jakupi	Anëtar	Prof	
Afrim Morina	Anëtar	Prof	
Shefaredin Vranja	Anëtar	Sh.civile	